



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

GRUPI PARLAMENTAR PARTIA E LIRISË

Nr. _____ Prot

Tiranë, më 14 tetor 2025

Lënda: Për një shtesë në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin e vlerës së shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Drejtuar: z. Niko Peleshi

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 81, pika 1, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", si edhe në nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin për një shtesë në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin e vlerës së shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin përkatës.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

Deputetët propozues:

Erisa Xhixho

Tedi Blushi

Edmond Haxhinasto

Brunilda Haxhiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2025

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 92, DATË 24.7.2014, “PËR TATIMIN E VLERËS SË SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Ne ligjin nr.92, datë 24.7.2014, “Për tatimin e vlerës së shtuar në Republikën e Shqipërisë , të ndryshuar “, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar prej 5 për qind aplikohet mbi mallrat ushqimore të shportës bazë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

RELACION PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 92, DATË 24.7.2014, “PËR TATIMIN E VLERËS SË SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”

Bazuar në nenin 81, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, u paraqit pranë Kuvendit të Shqipërisë për shqyrtim dhe miratim projektligji PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 92, DATË 24.7.2014, “PËR TATIMIN E VLERËS SË SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”.

Qytetarët shqiptarë janë përballur me rritjen e kostos së jetesës sidomos përgjatë tre viteve të fundit. Sipas INSTAT, për vitin 2024, ushqimet zënë 40% të buxhetit të familjeve, duke ruajtur të njëjtën peshë si në 2023. Ndonëse paguhen më pak se të gjithë qytetarët e BE-së, me rreth 41% të mesatares europiane, sipas fuqisë blerëse, qytetarët shqiptarë shumë produkte i blenë deri në 50% shtrenjtë se në Europë në vitin 2024, sipas indeksit krahasues të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga Eurostat.

Shqipëria ka fuqinë blerëse më të ulët në Europë, duke tejkaluar edhe Moldavinë dhe Ukrainën, pavarësisht se të dy këto vende e kanë pagën minimale më të ulët se vendi ynë.

Paga minimale – Paga minimale mujore bruto në Shqipëri ishte 408 euro në fund të muajt qershor, sipas Eurostat. Paga minimale është jo vetëm më e ulëta në Europë, por dhe shumë më e vogël edhe në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor. E pandryshuar që nga 6-mujori i parë i 2023, paga minimale në Shqipëri mbetet në nivelin e 40 mijë lekëve, ndërkohë që Mali i Zi e ka 670 euro, Serbia 618 euro, Maqedonia e Veriut 584 euro, ndërsa Bosnjë-Hercegovina 511-660 euro.

Ndryshe nga Shqipëria, vendet e rajonit i kanë rritur pagat minimale edhe pas vitit 2023. Në Serbi, paga minimale është rritur me 34%, Mali i Zi i ka rritur me 25% dhe Maqedonia e Veriut me 20% etj.

Pensionet - Me një pension mesatar 170 euro, më pak se gjysma e vendeve të rajonit, me rekordin që e mban Mali i Zi, me 450 euro në muaj, pensionistët shqiptarë nuk mbyllin dot muajin. Fuqia blerëse për një pensionist shqiptar është më e ulëta në Europë. 90% e pensionit të tyre shkon për ushqime, duke e patur pamundur të mbulojnë shpenzimet e tjera si ilaçe, faturat energjie apo uji dhe

shërbime të tjera. Kjo pamundësi e ka vendosur këtë kategori në kushtet e mbijetesës duke vuajtur rritjen e çmimeve më shumë se pjesa tjetër e popullsisë.

Qeveria nuk ka rritur as pagën minimale, as pensionet, por është mjaftuar me indeksime për pensionistët. Si pasojë, barra e rritjes së çmimeve ka rënduar më shumë mbi familjet me të ardhura të ulëta dhe mbi pensionistët. Kjo ka sjellë tkurrjen e konsumit dhe përkeqësimin e cilësisë së jetesës.

TVSH-ja - Rritja e çmimeve ka shtuar të ardhurat në buxhet përmes TVSH-së. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, prej janarit deri në fund të gushtit 2025 janë arkëtuar plot 499 miliardë lekë.

Shqipëria aplikon një TVSH prej 20% për ushqimet e shportës, e cila është më e larta në rajon dhe ndër më të lartat në Europë për këtë kategori mallrash.

Gjithashtu fiskale për bujqësinë kërkojnë ndrerhryrje të menjëhershme për të nxitur prodhimin bujqësor, për të mbrojtur prodhimin vendas dhe për të formalizuar ekonominë bujqësore. Unifikimi i barrës fiskale në cdo hallkë të prodhimit bujqësor do të jetë një iniciative e ardhshme e grupit të Partisë së Lirisë.

Krahasimisht:

- Kosova aplikon TVSH të reduktuar 8% për produktet bazë ushqimore;
- Maqedonia e Veriut – 5% për shumë ushqime bazë;
- Mali i Zi – 7% për artikuj të shportës;
- Italia – TVSH 4% për bukë, qumësht, miell;
- Greqia – 6% për produkte të konsumit të domosdoshëm.
- Bashkimi European – përmes Direktivës 2006/112/KE, i lejon vendet anëtare të aplikojnë norma të reduktuara (madje edhe 0%) për ushqime bazë.

Në këtë realitet, vazhdimi i aplikimit të TVSH-së 20% për mallrat e shportës në Shqipëri jo vetëm që dëmton konsumatorin fundor, por krijon edhe mungesë konkurrueshmërie për tregun vendas dhe rrit informalitetin, pasi çmimi i lartë inkurajon shmangien fiskale.

Ulja e këtij tatimi në 5% për një listë të kufizuar dhe të përcaktuar qartë të produkteve të shportës, nuk është vetëm një masë ekonomike, por një akt social dhe moral, në funksion të:

- Lehtësimit të kostos së jetesës për qytetarët;
- Mbrojtjes së konsumatorëve vulnerabël;
- Rritjes së transparencës dhe formalizimit të tregtisë ushqimore;
- Harmonizimit të legjislacionit tatimor me praktikën europiane.

1. Qëllimi i projektligjit

Qëllimi i këtij projektligji është ulja e barrës fiskale për qytetarët shqiptarë për mallrat ushqimore bazë, të njohura si “artikujt e shportës”. Aktualisht, këto mallra tatohen me normën standarde të TVSH-së prej 20%. Propozimi synon aplikimin e një shkalle të reduktuar prej 5%, në përputhje me praktikën më të mira europiane dhe për të rritur fuqinë blerëse të konsumatorëve, veçanërisht të shtresave në nevojë.

2. Nevoja për ndërhyrje ligjore

Në kushtet e inflacionit të lartë të viteve të fundit dhe rritjes së kostove të jetesës, sidomos në ushqime dhe energji, bëhet e nevojshme që politika fiskale të ndërhyjë në mënyrë të drejtpërdrejtë për të ndihmuar qytetarët. Artikujt e shportës bazë përbëjnë një përqindje të madhe të shpenzimeve mujore të familjeve shqiptare. Ulja e TVSH-së në këto mallra ndihmon në:

- Uljen e çmimeve për konsumatorin fundor;
- Rritjen e aksesit në ushqime cilësore;
- Mbështetjen e prodhuesve dhe tregtarëve vendas në formalizimin e ekonomisë;
- Harmonizimin me praktikën fiskale të vendeve të BE-së dhe rajonit.

4. Përmbajtja e projektligjit

Projektligji parashikon shtimin e një pike të re në nenin 49 të ligjit nr. 92/2014, ku përcaktohet qartë se për furnizimin me mallra ushqimore të konsumit bazë, do të aplikohet një shkallë e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar prej 5 për qind. Lista e produkteve që përfitojnë këtë shkallë të reduktuar do të përcaktohet qartë, duke siguruar fleksibilitet dhe kontroll të vazhdueshëm mbi zbatimin e politikës.

5. Ndikimi financiar dhe ekonomik

Reduktimi i TVSH-së në 5 për qind për artikujt e shportës mund të sjellë një ulje të përkohshme të të ardhurave në buxhetin e shtetit, por kjo humbje potenciale mund të balancohet nga:

- Rritja e konsumit dhe zgjerimi i bazës së tatueshme;
- Formalizimi i mëtejshëm i tregut të ushqimeve bazë;
- Rritja e besimit të konsumatorëve dhe stabiliteti social.

Në afat të mesëm, kjo ndërhyrje pritet të ketë efekt pozitiv në ekonomi, veçanërisht në rritjen e konsumit të brendshëm dhe në uljen e varfërisë ushqimore.

6. Përputhshmëria me legjislacionin e BE-së

Projektligji është në harmoni me Direktivën 2006/112/KE të BE-së, e cila u jep shteteve anëtare të drejtën për të zbatuar norma të reduktuara të TVSH-së për mallra dhe shërbime të konsumit bazë, përfshirë ushqimet. Një numër i konsiderueshëm i vendeve të BE-së aplikojnë norma të reduktuara për mallrat ushqimore (p.sh., 4% në Itali, 6% në Greqi, 5% në Poloni).

7. Konkluzion

Ky projektligj paraqet një ndërhyrje të drejtë dhe të qëndrueshme për të ndihmuar qytetarët në përballimin e çmimeve të larta të ushqimeve bazë. Do të ndikojë në përmirësimin e furnizimit me produkte cilësore të vendit të industrisë turistike. Ulje e kostos së jetesës dhe veçanërisht për familjet e reja. Rritje e sigurisë ushqimore me produkte të sigurta të vendit. Ai është i harmonizuar me standardet evropiane dhe ka potencial të madh.

Lista e artikujve ushqimorë të shportës bazë

1. Bukë (bukë gruri, bukë misri)
2. Miell gruri

3. Oriz
4. Makaronat dhe produktet nga gruri
5. Vaj ushqimor (vaj luledielli, vaj ulliri i zakonshëm)
6. Sheqer i bardhë
7. Kripë e jodizuar për konsum ushqimor
8. Qumësht i freskët dhe i pasterizuar
9. Kos dhe produkte të tjera të fermentuara të qumështit
10. Djathë i bardhë (i lopës, deles, dhisë)
11. Vezë të freskëta
12. Mish i freskët (viçi, qengji, pule)
13. Peshk i freskët dhe i ngrirë i konsumit të përditshëm
14. Patate
15. Qepë
16. Hudhra
17. Fasule të thata
18. Thjerrëza
19. Bizele të thata
20. Karrota
21. Domate (produkte sezonale të konsumit bazë)
22. Fruta bazë sezonale (mollë, portokalle, banane) – në sasi të caktuara
23. Ujë i ambalazhuar për konsum shtëpiak

